

E Lirë si Liria, jo e Lirë si një send i lirë në çmim

Ju nuk duhet të paguani për shumicën e Programeve Kompjuterike të Lira. Shumë nga programet kompjuterike pronësorë janë falas, por Programet Kompjuterike të Lira nuk kanë të bëjnë me çmimin: kanë të bëjnë me lirinë.

Kur nuk mund të kontrolloni dot një program, është programi që iu kontrollon ju. Kushdo që kontrollon një program kompjuterik, ju kontrollon edhe iu rrjedhimisht.

Për shembull, asnjë njeriu nuk i lejohet të studiojë se si punon një program kompjuterik jo i lirë dhe çfarë saktësisht bën ai në kompjuterin apo telefonin tuaj. Ndonjëherë, të metat e një programi kompjuterik jo të lirë konsistojnë në dështimin e arritjes së pritshmërive. Gjithsesi, shpesh programet kompjuterike jo të lirë shkaktojnë rrjedhje të të dhënave tuaja ose fshehin karakteristika të tjera me qëllim të keq.

Nëse ekzekutoni vetëm Programe Kompjuterike të Lira në kompjuterin apo pajisjen tuaj, iu vë juve në kontroll të plotë të saj. Edhe pse ju mund të mos keni aftësitë të ushtroni të katërta liritë vetë, do të përfitoni nga njohuritë dhe ekspertiza e një komuniteti plot energji dhe entuziazëm.

Kini parasysh se mund të tregoni vlerësimin tuaj duke paguar vullnetarisht zhvilluesit. Kjo gjithashtu ju siguron se ju jeni konsumatori dhe jo produkti.

Çfarë është Programi Kompjuterik i Lirë?

- 1 Përdorimi:** Program kompjuterik, të cilin çdokush mund ta ekzekutojë lirisht, për çfarëdolloj qëllimi.
- 2 Studimi:** Program kompjuterik, të cilin çdokush mund ta këqyrë dhe përshtasë për dëshirat apo nevojat personale.
- 3 Shpërndarje:** Program kompjuterik, të cilin çdokush mund ta kopjojë dhe shpërndajë lirisht.
- 4 Përmirësimi:** Versione të përmirësuara të një programi kompjuterik mund të shpërndahen: i gjithë komuniteti përfiton nga përmirësimet.

Në mënyrë që një program të jetë plotësisht Program Kompjuterik i Lirë, ai duhet të sigurojë të gjitha këto liri, për gjithësecilin.

Rreth FSFE

Kjo fletushkë është bërë nga Free Software Foundation Europe (FSFE), një organizatë jofit-imprurëse, e dedikuar në promovimin e Programeve Kompjuterike të Lira dhe në ndërtimin e një shoqërie dixhitale të lirë.

Aksesi në programe kompjuterike përcakton se si ne mund të marrim pjesë në shoqëri. Prandaj, FSFE i është dedikuar sigurimit të një aksesi dhe pjesëmarrjeje të njëjtë të të gjithëve në moshën e informacionit, duke luftuar për lirinë dixhitale.



Asnjë nuk duhet të detyrohet të përdorë programe që nuk mund t'i shfrytëzojë, studiojë, shpërndajë dhe përmirësojë. Ne duhet të kemi të drejtën e adaptimit të teknologjisë në atë mënyrë që t'i përshtatet nevojave tona.

Puna e FSFE-së jep rezultat nga përpjekjet e një komuniteti njerëzish që i janë përkushtuar këtyre qëllimeve. Ka shumë mënyra për të ndihmuar, nëse dëshironi të na bashkoheni dhe të na ndihmoni në arritjen e qëllimeve, pavarësisht formimit:

<http://fsfe.org/contribute>

Mbështesni punën tonë

Donacionet janë shumë të rëndësishme për të vazhduar punën tonë dhe siguruar pavarësinë e Fondacionit. Ju mund të mbështesni punën tonë duke iu bashkuar programit "Anëtarët shok" dhe të mund të vazhdojmë luftën për lirinë e programeve kurdoherë që është e nevojshme:



<http://fsfe.org/join>

Free Software Foundation
Europe e.V.


office@fsfe.org

<http://fsfe.org>

2015-04-21



Liri




Çfarë kanë të përbashkët Programet Kompjuterike të Lira dhe mjetet?

Një krahasim

Programet e Lira Kompjuterike na ofrojnë disa liri esenciale që mohohen nga kategori të tjera programesh. Shumë prej nesh janë mësuar me kufizime dixhitale serioze, që përbëjnë një analogji perfekte me një pajisje fizike që na vjen në ndihmë shpesh.

Programet e Lira Kompjuterike mund të përdoren si një vegël. Le të analizojmë pasojat absurde që do të sillte përdorimi i kaçavidave me të njëjtat kufizime të programeve të patentuara.



1

Kaçavidat nuk do të ishin të standardezuar dhe do të funksiononin vetëm me vida të prodhuara nga e njëjta kompani.

2

Licensat e kaçavidave do të lejonin vetëm zhvildosjen e vidave. Për të përshpejtuar procesin, do të kishim nevojë për një kaçavidë më të shtrenjtë nga i njëjti prodhues.

3

Vetëm një kompani do të lejohet të prodhojë kaçavidat sepse ideja do të patentohet. Vetëm me një produkt provë të shtrenjtë do të mund të kishim të drejtën për të shtrënguar me pinca apo zhvildosur vidat.

4

Nuk do të lejoheshim të modifikonim kaçavidat sipas nevojave tona. Për shembull, do të ishte e ndaluar t'i vendosnim ngjitëse tek bishti për të mos lejuar rrëshqitjen e kaçavidës.

5

Do të ishte e jashtëligjshme të riparonim një kaçavidë të prishur pa lejen e prodhuesit. Qoftë edhe për ta shpërbërë atë, për të mësuar si funksionon.

6

Kaçavida dhe vida të reja do të hidheshin në treg në mënyrë konstante. Ato nuk do përputheshin me modelet më të vjetra. Kështu, ne do të kishim nevojë të blinim kaçavidat të reja.

7

Do të ishte e jashtëligjshme të huazonim apo t'i shisnim kaçavidat tona.

8

Kaçavidat do të na spiunonin dhe informacionin e mbledhur do ta shpërndanin tek persona të jashtëm (ose kompani ose qeveri), pa dijeninë tonë.

Asnjë nuk do të përdorte kaçavida, përdorimi i të cilave do të ishte i kufizuar. Nuk ekzistojnë baza të arsyeshme për të pranuar kushte të tilla. As për pajisje, as për programe.

Liritë që i konsiderojmë evidente me pajisjet, janë të mundura edhe për kompjuterat. Programet e lira mund të instalohen kudo pa kufizime. Duke qenë se programet e lira bazohen në standartet e hapura, dokumentet tuaja mund të hapen me programe të ndryshme vite më vonë.

Nga ana tjetër, patentat e programeve, DRM* – Menaxhimii Kufizimeve Dixhitale, standartet e mbyllura, licensat e programeve pronësore dhe kushtet e padrejta të shërbimeve janë mënyra për të kufizuar liritë e përdoruesve.

* DRM është akronimi i Digital Restrictions Management

Ku përdoren Programet Kompjuterike të Lira?

- Në kompjutera desktop dhe laptop:

Ekziston një sasi e panumërt i programeve të lira për çdo detyrë, projekt dhe përdorim ditor. Ja disa shembuj:

GNU/Linux është një sistem operativ i hapur dhe i lirë. Ai vjen në versione të ndryshme, të quajtura distribucione. Disa janë më të përshtatshëm për përdorues fillestarë, e disa të tjerë për të përmbyshur nevojat specifike profesionale.

Mozilla Firefox, VLC, Audacity & LibreOffice janë vetëm disa shembuj të programeve kompjuterike të lira, që përdoren gjerësisht, dhe ka edhe mijëra të tjerë.

- Në pajisje të tjera:

Është mëse e zakonshme të kemi me vete gjatë gjithë kohës disa kompjutera. I quajmë 'telefona të zgjuar', 'tableta' apo 'lexues elektronik', por ata janë kompjuter, shpesh me kufizime të shumta.

Telefonat Android janë një shembull i pajisjeve që mund të shndërrohen në pajisje të lira. Për më tepër informacion, vizitoni

<https://freeyourandroid.org>

- Në kompjuterët, kudo rreth nesh:

Lista e objekteve elektronike të kontrolluara nga kompjuterët, të cilët nga ana e tyre kontrollohen nga programe, është e pafund. Programet e patentuar përdoren ende në disa prej këtyre pajisjeve. Megjithatë, për fatin tonë të mirë programet e lira kanë fituar terren në:

furra njohës CD pjata-larëse	televizorë makina projektore	sistemet e ngrohjes trena helikopterë të kontrolluar nga distanca...
------------------------------	------------------------------	--

Infrastruktura e internetit gjithashtu, mbështetet gjerësisht në programet e lira, ashtu si dhe 'web'-i.

Modemët ruterat VPN	serverat DNS mail serverat web serverat	bazat e të dhënave programet e blerjeve online...
---------------------	---	---